



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "BALLI KOMBËTAR" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Lezhë të depozituara nga Partia "Balli Kombëtar" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Balli Kombëtar", si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Balli Kombëtar, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.



**Nr. 497 i Vendimit**

**Data 17.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Lezhë të depozituara nga Partia "Balli Kombëtar" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia Balli Kombëtar ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore.

Në mbledhjen e datës 17.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Partisë Balli Kombëtar dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Vërtetim për zotërimin e mandatit sipas nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, /Listën e zgjedhësve që mbështesin partinë/koalicionin;
2. Certifikatë lindjeje/personale ose kopje e dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët;

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga Partia "Balli Kombëtar".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

#### **V E N D O S I:**

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Bashkisë Lezhë, të Partisë Balli Kombëtar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 497 i Vendimit**

**Data 17.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Lezhë të depozituara nga Partia "Balli Kombëtar" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019